



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL IMBLEDHJES SË SHTATË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 31.07.2019 (e Mërkur) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, kryetari, z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahimimi, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Remzi Salihu, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e shtatë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të ju përshëndes juve të pranishëm, ju informoj që kemi marr konfirmimin e ligjshmërisë nga MAPL-ja të akteve të cilët i kemi nxjerr nga seanca e fundit e Kuvendit Komunal. Tani kalojmë te pyetjet jashtë rendit të ditës.

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Kame pyetje për ekzekutivin, kame një kërkesë nga lagja “Martiret e Demirëve” që të behet ndreqim publik. Fshatarët e fshatit Pozharan kanë bërë me vete financim dhe i kanë gjetur hapësirat publike, mirëpo kanë nevojë për ndriçim publik. Kame pyetje, se pse nuk po shtrohet rruga “Daut Sadiku” ani pse është premtu qyshe në fushatën e vitit 2014, kjo i ka kalu të gjitha procedurat ligjore që duhet t’i kaloj, mirëpo asnjëherë nuk u gjend me agjendën e juaj. Pyetje tjetër, është një shqetësim mjaft i madhe në Komunën e Vitisë, mu afër QKMF-së gjendet një gropë, ku një qytetare thotë se jam në hall, jemi në sezonin e verës dhe kjo gropë kundërmon dhe në të njëjtën kohë paraqet rrezik edhe për fëmijët. Po ashtu kur të ja shtojmë edhe koston financiare buxhetit familjar, që duhet të pastrohet kjo rrugë, është “Rruga e Preshevës”, jo vetëm një herë, po është cek shumë herë edhe nga koleget. Është absurde që në Viti kjo lagje nuk ka kanalizim, është mu përball ETC-së, kjo paraqet rrezik edhe për fëmijët po edhe për ambientin. Në të njëjtën kohë kërkoj ku edhe në seancën e kalime kam kërkuar raport ose përgjigje lidhje me kompensimin që është kërku në ministri për bujqit, ata po pyesin se a do të ketë apo jo kompensim.

z.Zekirja Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Ju shprehi mirëseardhje diasporës dhe ju dëshiroj qëndrim të këndshëm në familjet e tyre, dhe në komunën tonë një dukuri jo e mirë po paraqitet para këtyre qytetarëve tanë dhe kjo dukuri janë lypsarët që nuk po i lanë rahat edhe një kafe me e pi. Në seancën e kaluar kemi prur një rregullore për të drejtat e fëmijëve, po tash duhet të kalojmë nga rregullorja në veprim. Përderisa jemi këtu në kuvend, jashtë këtij pallati kemi fëmijë të shtrirë përtokë dhe duke lypur lëmosh dhe ata janë shumë po ka edhe të rritur. Ne nuk e dimë as nga vinë dhe nga janë. Unë kërkoj dhe propozoj që të merren masa nga të gjithë ne, duke i përfshirë policinë, entin social, shoqërinë civile, qeverinë komunale, kuvendin dhe të gjithë së bashku ta parandalojmë këtë dukuri

negative për qytetin tonë. Pra, të dal policia me një aksion për ndalimin e kombi buzëve me lypsar, të identifikoj ata dhe t'i nxjerr para drejtësisë vartësit e tyre.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Një informatë me çështjen e ujësjellësit e ka fillu me shumë se dy vite në Smirë dhe përpos rrjetit që pjesërisht është shtri, nuk ka diçka të pritët, as që është në rend të përfundoj. Besoj që një informatë më e plotë të na jepet për këtë pjesë. Kam kërkuar, kryesuesi e di që kam kërku që në këtë seancë të vjen edhe një pikë e rendit të ditës, që në KPF jemi marr vesh, që pika e rendit të ditës për ndërtimet pa leje, tu e pas parasysh që është një dukuri që e ka shëmtu vendin në përgjithësi, jo vetëm Vitinë po të gjithë Kosovën. Kam kërku një informatë që nuk e keni sjellë këtu që dy seanca. Edhe drejtori ka pas me pru një informatë për një investim që është bë në Tërpezë, të parku, atje te pishat, ku edhe atje në bazë informatave që i kemi, një qeshmë ka kushtu 500 euro, e cila qeshmë është 20 euro, edhe këtë informatë nuk e keni sjell ende.

z.Besim Ymeri: Përshëndetje për të gjithë! Kërkoj një informatë për rrugën Sadovinë – Dardani, ku kanë mërri punët dhe për çka nuk është kry ky asfaltim, dhe dashta të ju falënderoj për këtë urën që është ndertu, e cila shërben për të mirën e kësaj lagje këtu pas shtëpisë se kulturës.

Znj.Xhilsime Qamili: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë kam një pyetje për drejtoreshën e Arsimit. Deri ku kanë arritur procedurat që të funksionalizohet çerdhja e cila vetëm është në procedurë. Bëhet fjalë për shkollën e Qifllakit, pasi që kërkesat e qytetarëve të asaj ane janë ne vazhdimësi, e ne realitet me hapjen e asaj çerdhe do të lehtësohet shume puna e nënave, sidomos atyre që janë të punësuar dhe atyre që presin të krijojnë marrëdhënie pune.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje për të gjithë. Unë kam dy pyetje për drejtorin e Financave. Njëra e cila po me imponohet vazhdimisht, me keni sjell faturat apo jo, nëse po mi jepni, e nëse jo pse nuk i keni sjell faturat që kane të bëjnë me përmbaruesin për Flakadakun e Karadakut, që janë gjashtë fatura, prej të cilave dy mi keni sjell dhe katërta i keni anashkalu. Se di hera e sat po i kërkoj këto fatura. Dhe pyetje tjetër është, a mund me na tregu se kush është personi apo cili avokat është percaktu për tatimin në pronë si përmbarues dhe nëse është një i vetëm, a mos mund të jetë ky ndonjë monopol apo konflikt interesi dhe bazë çfarë ligji është përzgjedh ky.

z.Sejdi Emini: Kam një pyetje për të gjithë. Cili doni me dal me pre shiritin tash të autostrada atje, kur sipas të gjitha gjasave po vinë zgjedhjet dhe keni me pas fushat cili nga ju keni me dal me pre shiritin. Tash ju pyes të gjithëve juve, tash nuk e di qysh kanë me pas fytyrë ata deputet, ata mashtrues të cilët për një kohë të gjatë kanë bë fushatë me qytetarët e Komunës së Vitisë. Unë besoj që nuk ka me qenë e përgjegjshme që na tash mi pru ata në viti e me bë fushat për ta, sepse qytetarët e Vitisë i kemi rrejt i kemi mashtru. E kame ngrit me herët, po e ngris prapë sot, problemin e trotuarit përball shtëpisë së kulturës atje, të ish restaurant “Lindi”. Nënkryetari ka pajtu plotësisht dhe ka thanë, që është e nevojshme dhe kemi me keshyr me bë zgjidhje. Zgjidhja është e nevojshme aty tash bënë një compromise, aty rregullone atë tretuar, sepse është zgjidhje afatgjate. Për mendimin tim, për një kohe pese vite, Vitia ke mu ngulfat prej ndërtesave të mëdhaja që sa përnime, ka mu bë gjendja e papërballueshme, e kemi një pjesë të mrekullueshme lumin prej Vitisë në Binçë me bë një plan të mirë zhvillimor, në dy anët e lumit mu bë ndërtesa, objekte, ashtu qysh i ka hije. Asgjë nuk ka Prizreni me shume se Vitia, e ka lumin natyral, ku njerëzit investoj me mija miliona me be sene të mira. Unë mendoj që ka ardh koha me bë punë, me dhënë ide afatgjate. Ujësjellësi ne Gushicë. Në seancën e kalume u bë apel që me pas një intensitet me të madh, mu bë puna pak me shpejt. Nuk e di, vetëm një vij e kane bë që nja katër pesë ditë. Nuk e di që dy jave ku kane shku. Ai zotëriu, ajo kompania, qytetarët janë duke u maltretuar me këtë farë pune. Edhe një rrugë atje, rruga e Malit është edhe një pjese e varrezave ku kemi pas rastin ku një qytetar ka vdek. Ajo pjese për me qu të varrezat perime ka qenë shumë shumë e vështirë, është e domosdoshme mu shtru ajo rrugë, sidomos deri të varrezat.

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Duke pasur parasysh që në komunën tonë pjesa dërmuese e buxhetit shkon në shtrimin e rrugëve rurale, në asfalt, është e pamundur nëse njëherë ne dalim në seancë e nuk perëndimi ndonjë rrugë e cila është shtru e është arnuar, është dëmtuar. E kemi rastin e rrugës Ramnisht-

Lubisht, e cila është arnuar në nëntorin e vitit të kaluar dhe momentalisht është kështu kjo gjendje si në foto. Gjithashtu mbi 62 mijë euro në Komunën e Vitisë janë shpenzuar për hartimin e projekteve, trotuari që është ndërtuar në fshatin Drobesh, i cili nuk ka as dy javë që është përfunduar pjesa dërmuese e trotuarit është në këtë gjendje. Shife ne foto, e dimë që kryetari përpos personave kompetencë që i lënë aty për me i përcjell projektet, del edhe vetë, dy herë ka qenë në Drobesh. Tash nuk e di si mundet me u përfundu një tretuar në këtë mënyrë, në këtë gjendje asnjë muaj nuk kanë kalu. Gjithashtu për shkak që me duhet mu largu më herët nga seanca, sepse e kam një udhëtim, që pika e pese e rendit të ditës, propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për inicimin e themelimit të Teatrit të Qytetit. Deshta ta ceku që teatri I qytetit të Vitisë ekziston tash e 30 vite si OJQ, me emir teatri I qytetit. Deshta me cek që është mirë me u zyrtarizu teatrin e jo mu themelu, sepse teatri ka ekzistuar që 30 vite, sepse në këtë rast po politizohet puna e disa personave.

z.Jakup Demiri: Përshëndete për të gjithë! Kame një kërkesë prej një lagje në Smirë, prej xhamisë e deri në fund të fshatit lagja “Asllanovit” dhe “Halilovit”, kanalizimi është mbyll në atë lagje. Për shkak se është blloku ka pas kërkesa prej banorëve, nuk keni intervenu deri me tash, e tash janë mbyll. Edhe te trotuari ne Smirë, është i dëmtuar prej punimeve që i kanë bërë në atë kohë, prej atëherë nuk ka ardh askush me keshy, prej atëherë po kam shumë kërkesa prej qytetarëve që bëjnë kërkesa, a ka naj sen për këtë tretuar.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ishin pyetjet kryesish të përsëritura, e disa ndoshta me fajësinë e ekzekutivit dhe sot e kemi pas një agjendë që është shumë e ngjeshur dhe voluminoze, ndoshta edhe kjo ka qenë shkaktar e mos dhënies së disa informatave që i ka kërkuar Bekimi. Unë një nuk e kam të kuart, shtroni kërkesa të qytetarëve. Kërkesat e qytetarëve mundën me qenë të shumta. Unë po jav përsëris edhe njëherë kërkesat dhe këshilltarët e kuvendit komunal dhe ekzekutivi, gjithherë duhet të sillet rreth programit të kandidatit i cili e ka fitu postin e kryetarit. Qëllimi i tij është realizimi i saj përmes se cilës e ka fitu votën, ndërsa të gjitha kërkesat janë të nevojshme, mirëpo përparësi merren ato që i ka në program. Nuk i kam tash të gjitha informatat, mirëpo të gjitha ato që janë në programin e kryetarit, ai ka me insistu me çdo kusht me i realizu, sepse pas katër viteve do të shihet sa u kanë i përgjegjshëm. Çështja e gropës u ngrit shumë herë, e cila ende nuk është zgjidh, po megjithatë ekziston një gropë, jo që nuk ekziston kanalizimi, po një gropë e cila mendojmë që meriton një tretman tjetër, po mundësitë buxhetore deri tash kanë qenë të tilla dhe do ti vjen radha edhe kësaj çështje. A do të kompensohen bujqit ishte pyetje. Unë besoj që nëse qeveria i lëshon paret, ne nuk është problem me i kompenzu hiq, sa çështje e jona, kërkesa është bërë nga ne vitin e kaluar, në momentin ku komisioni komunal ka konstatuar dëmet sa kanë qenë në fushat e Vitisë, gjegjësisht në Skifteraj. Kërkesa i është dërgua ministrisë, tash është çështje e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Bekimi kërkoj disa informacione, kemi me i sjell edhe këto informata. Besimi pyeti për rrugët, kemi pas një telashe, atje ka qen dashur mu bërë edhe një kërkesë e re, tani është tenderu, se shpejt pritet me fillu rruga dhe asfaltimi. Sejd, te prerja e shirit vetëm le të bëhet ajo çështje, kemi me pre bashkë shiritin. Unë e kam pas një takim me deputetët e ku ju nuk keni qenë prezent, përveç Liridonës, e unë ju kam thanë në sy, se çka ka qenë dashur me bërë për kyqjen e Vitisë në autostradë, nuk e kanë bërë asnjeri deputet, nuk ka pas arsye që mos me bërë. Te restaurant “Lindi” e kemi bërë një zgjidhje të përkohshme me shenjzim, po do të shohim në vazhdim. Janë ka punojnë, në planin zhvillimor komunal duhet të përfshihen të gjithë, mendoj se duhet me dhanë kontribut të gjithë ata të cilët kanë ide lidhur me të dhe të parashihen se këto nuk rregullohen për dy vjet apo për pesë vite por duhet të rregullohen në aspekt shumë ma të gjatë. Te çështja e ujësjellësit, unë besoj se kompania e ka planin dinamik. Rruga e malit duhet me shikua, Libidonë nja 20 herë i ke fotografuar i ke ba shumë të përsëritshme, ndoshta është mirë me u fokusuar diku tjetër tash ajo është prish e ka pasur një garancion, e kanë rregulluar 62 mijë euro. Trotuari, mbytt je duke e ngritur, tash hala pa e bërë pranimin teknik po i gjen vërejtjet. Çështja e teatrit, është mirë mos me politizuar për një arsye. Ka qenë një trupë teatrale që ka vepruar, askush nuk e konteston, por këtë çështje duhet me themeluar dhe themelues i kësaj është kuvendi. Ti flet për një trup që ka vepruar në kohën e okupimit, që nuk ka pasur vendim, dhe në rast se ti në shekullin 21 thua duhet të veprojmë pa një vendim të

themelimit, unë nuk pajtohem asnjëherë me ty, se na duhet me pas një dokument. Jakup, do ta marrësh përgjigjën nga drejtori, dëmtimi i trotuarit, kompania e cila e ka dëmtuar e ka për detyrë me kthye në gjendjen e mëparshme.

z.Skender Ahmeti: Unë dola të ju përgjigjem një pyetje Bekimit, jo se isha në pushim, se unë do ta kisha bërë përgjigjen përkundër se kam respekt për Bekimin, pyetja e cila është për informatën për ndërtimet pa leje në Komunën e Vitisë, është një pyetje e përgjithshme, për shkak se pyetja duhet ta ketë një periudhë të caktuar. Na për të gjithë ata që e kanë kaluar metrin katror keni proceduar kundërvajtje në gjykatë, gjendja e ndërtimeve nuk është asnjë pa leje, ndërsa familjare ka, por edhe ato janë telashe të padefinuara. Edhe një lutje Bekim, nëse të intereson me marr informatë, urdhëro afatizoje për atë kohë sa unë kam udhëheqë të jap përgjigje edhe me shkrim edhe me gojë.

z.Ibrahim Rama: Një pyetje nga Bekimi rreth investimit të pishat në Terpezë. Po, do ta merr, nuk e kam përgatitur për këtë seancë për një arsye të thjeshtë, se projekti është dyvjeçar, nuk ka qenë i kompletuar, sepse s'ka qenë projekt i ndarë, por ka përfshi pjesë të hapësirave publike në tërë territorin e Komunës së Vitisë dhe si projekt s'ka qenë i përfunduar, sepse ka qenë dyvjeçar. Faktuarat e përmbaruesit privat nga Remziu. Këtu "Flakadani i Karadakut", disa herë janë kërkuar. Unë kam prur aty, nuk janë çek me faktuar, por aty veç kush është paguar. Nëse keni ju ndonjë informacion për katër faktuarat që ju pretendoni që janë paguar dhe nuk i kemi paraqitur na, atëherë unë kërkoj ndjesë dhe kërkoj mundësi që me ju a sjellë ato faktura, që ju pretendoni që nuk i keni pasur shënimet edhe një pyetje tjetër nga profesori ka të bëjë me përmbaruesin privat që komuna ka marrëveshje për inkasimin e obligimeve të tatimit në pronë me ligj komuna ka të drejtë të ja japin punën e inkasimit të gjitha obligimeve pa përjashtim jo vetëm tatimit në pronë, një përmbaruesi privat që komuna e konsideron që mundet me i krye punët, përmbaruesi privat është Kushtrim MN "Musa" në Gjilan dhe kemi marrëveshje me të dhe një pyetje tjetër nga Sejdiu që ka të bëjë me ujësjellësin e Gushicës. Po ky është projekt bashkëfinancim i vjetër i vitit 2012 që e financon CDI-ja, Komuna, dhe komuniteti ka mbet i pa realizuar, nuk e kemi paguar asnjëherë ekzekutimin e këtij projekti e ekzekuton CDI-ja. Na nuk jemi akter as në procedura të tenderimit as të mbikëqyrjes përveç kryetari i komunës se e ka mbikëqyrjen si autoritet në territorin administrativ.

znj.Fatbardha Emini: Doktoresha pyeti rreth çerdhes së Qifllakut. Ministria me kërkesë tonën ka filluar të bëjë politika të reja për vitin 2020, që shkolla të cilat kanë mungesë të nxënësve t'i shndërroj në çerdhe, kështu që për vitin e ri 2020 besojmë se Komuna e Vitisë do të jetë e para që do të fillojë implementimin e kësaj politike.

z.Negjmedin Jakupi: Në bazë të informatave që i kemi ne kemi intervenuar në atë pjesë diku nja 4/5 puseta i kemi pastruar, ka rregulluar aty një pjesë tjetër informatë që ka prapë defekt aty nuk kemi un seriozisht do të merrem pas këtij takimi dhe do të diskutoj edhe me ty Jakup dhe besoj se e zgjidhim këtë problem

Kryesuesi z.Naim Pira : besoj tjera pyetje nuk pak nëse ka dikush replikë urdhëroni ju lutëm

z .Bekim Azizi; na e kemi diskutuar edhe në KPF na kemi kërkuar për pjesën e Vitisë që ka plan zhvillimor të hartuar e dimë që ka ndërtime pa leje sa dush, na e kemi kërkuar një informatë me pa një gjendje sa është tejkaluar vendi i ndërtimit, toka bujqësore që janë kanë të kufizuara, se edhe na nuk jemi duke kërkuar çdo shtëpi private, pra përudhen prej planit zhvillimor prej vitit 2013 e deri tash edhe isha lidh pak te kërkesat me nënkryetarin me planin e kryetarit qa i ka paraqitur në fushatë, investimet nuk i banë kryetari me para të veta, i banë me pare të qytetarëve edhe çdo nevojë që kërkohet për qytetarët na e kemi për detyrë me kërkuar, tash ata që e ke paraqit në fushat ti nuk e ke çekë atë gropë që e kërkoj Jakupi, se nuk e ke dit që nxihet, por ju e keni për detyrë me intervenuar 22 mijë i ke pas dëme që ju ka hy uji në Budrikë ju ato pare i keni marrë i keni qua në investime kapitale. Qeveria i ka tërhek na jemi duke parë se komunat tjera kanë marrë miliona për dëme, Rahoveci ka marrë miliona euro për dëmet e shkaktuara, ndërsa ne skemë marr asnjëherë a dëme qa ka pasur Vitia prej mbas lufte, nuk mendoj se ka pas asnjë komunë në Kosovë, mirëpo unë nuk e di që janë kompensuar dëmet.

znj.Mirlinda Sadiku: Pajtoj plotësisht me kolegun Bekim, Mamusha është kompensuar, është kompensuar edhe Suhareka, pse mos me u kompozuar edhe Vitia. Unë kam diskutuar edhe atëherë kur Vetoni ka qenë drejtor, por

pse gjithmonë Vitia po anashkalohet, ndërsa sa i përket kërkesave të qytetareve, sa herë të ketë nevojë qoftë edhe vetëm një qytetarë i vetëm me parashtruar kërkesë, unë kam me adresuar këtu, për atë arsye edhe e kemi votën e tyre. Sa i përket rrugës, unë kam kërkuar qasje në dokumente publike dhe komisioni për pranim teknik me ka thanë se materiali është kontrolluar dhe është pranuar nga kompania, andaj ne si komision për pranim mendojmë se i ka plotësuar kushtet për pranim teknik kështu me ka than komisioni për pranim.

z.Jakup Demiri: Te kjo puna e trotuarit, unë e përmenda kanalizimin, se edhe në kohën e kanalizimit është dëmtuar. Kush ka punuar aty e ka dëmtuar trotuarin në Smirë prej rrethi e pjesën tjetër shumica është i dëmtuar. Ky është halli im edhe komuna kurrë nuk ka dal me shikuar një herë me pa qa u bë aty. Po lidhem edhe te punimet, po të them kryesues, se qëllimi i çdo asamblisti edhe puna e tij do të jetë në shërbim të qytetareve, p.sh. trotuari te varrezat e dëshmoreve ditën që është promovuar shihet zalli në atë asfalt ditën që është promovuar. Unë mendoj se dikush duhet me dhanë përgjegjësi e jo çdoherë me u dëmtuar qytetari. Në komunën tonë riparohen punët që kryhen brenda muaji .

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Bekim, nëse ke mund me keqkuptuar, nëse donë me thanë ashtu e thua, por është mirë me thanë të vërteten, askush nuk thotë ndahen çështja e mirëmbajtjes dhe çështja e investimeve kapitale, se çdo dëmtim duhet të rregullohet. Çështja e investimeve, prioritet i jep programit të vet, e shtruat edhe dëmtimet në bujqësi na do të ishin ni fajtor nëse komisioni nuk e kish kryer punën e vetë edhe kërkesën nuk e kish dërguar me kohë, por s'na ka qëlluar asnjë i Anamoravës, andej edhe nuk na i kanë marr për bazë. Na kemi bërë maksimumin për mos me u dëmtuar ata bujq. Na pa lejen e ministrisë kemi bërë pastrimin e “Moravës”.

z.Sejdi Emiri: Po lidhem edhe njëherë te ujësjellësi në Gushicë. Kërkesa ishte, pse janë ndërprerë punimet. Plus, është prit prej vitit 2010 tash menxi që është bërë, u punua një kanal 1 km edhe janë ndërprerë, prandaj nuk është e përgjegjshme veç me ardhur me fillua edhe shko tjetërkund dhe 5 mijë euro janë të qytetarëve te CDI-ja. Është mirë ti me bashkëpunuar me ta me ja ndal ato pare edhe ato mjete me ja kthye qytetareve. Nënkryetar, deshe me zhvendos fajin me qit në personale te puna e autostradës. Unë mendoj se është shumë shoqërore.

Kryesuesi z.Naim Pira: Nëse s'ka tjerë për të diskutuar, për seancën e shtatë kemi paraparë këtë:

Rend dite

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Kuvendit Komunal të Vitisë.**
- 2. Informatë për punën e kryetarit të komunës për periudhën janar-qershor 2019.**
- 3. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2019.**
- 4. Informatë lidhur me Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare te Komunës së Vitisë për vitin përfundimtar me 31.12.2018.**
- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për inicimin e themelimit të Teatrit të Qytetit**
- 6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës se Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2020.**
- 7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik për propozim rregullore për Tatimit në prone për vitin 2020.**

Dhe nga Drejtoria për Financa me kanë informu, se e kanë edhe një pikë tjetër të rendit të ditës, **propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendim për shpalljen në diskutim publik propozim rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2020.** Këto dy propozime të fundit shkojnë për diskutim publik.

Hapim debat rrethe rendit të ditës, a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

z.Njazi Isaku: Këto të gjitha pikat janë pa rekomandimin e KPF-së, atëherë edhe na ju kisha lutë me i tërheqë krejt këto pika, sepse jeni duke bërë shkelje ligjore nëse në seancë vinë pa rekomandimin e KPF-së. Këtë po e them tu e ditë përgjegjësini e KPF-së që është për këtë punë me bë rekomandime për seancën, duke i futur krejt këto

pika, duke bërë shkelje. Mendoj se edhe MAPL-ja ka me reaguar për krejt këto pika, për arsye se po bëhet shkelje. Ne nëse nuk i tërhiqni këto pika, me përjashtim të informatës së kryetarit, ne nuk do të jem pjesë e kësaj seance.

Kryesuesi z.Naim Pira: Është e drejtë këshilltarëve komunal me pas propozime, është e drejtë me pas mendime dhe ta dini se një organ që e monitoron dhe e përcjell punën e kuvendit komunal nuk është as kuvendi komunal, as këshilltarët, por është një organ nga MAPL-ja. Nëse ju mendoni se unë jam duke bërë shkelje që i kam sjell pa rekomandim, ju bëni kërkesën, do ta nënshkruajmë dhe do të ja dërgojmë ministrisë, ajo e cila është përgjegjëse edhe në seancën e fundit e ke ngritur një çështje të tillë rrethe KAB-it edhe jeni prononcuar edhe për media. Një gjë të tillë unë ja kam dërguar organit që e bënë ligjshmërinë e këtyre akteve dhe ministria na i ka kthye dhe na i ka shpallur të ligjshëm vendimin, d.m.th. unë i besoj organit i cili e monitoron dhe e vlerëson punën e kuvendit komunal. Unë apeloj që ju të jeni pjesë e seancës.

z.Bekim Azizi: Unë mendoj se ti kryesues je zgjedhur prej kuvendi, nuk të ka zgjedhur kryetari dhe duhet me ju përmbajt rregulloreve, që ky kuvend i ka nxjerrë dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Kryetari i kuvendit ka për detyrë që pikat me i kaluar përmes KPF-së dhe gjitha veprimet që bëhet janë në mënyrë të ligjshme që shkohet deri në kuvend dhe miratohet dhe rekomandohet prej KPF-së. Ti nuk i ke të rekomanduar prej KPF-së, na e dimë se ajo nuk është mbajtur edhe seanca e kuvendit s'ka pas kuorum para kësaj here dhe nuk është mbajtur kur e keni bërë numrin e ke mbajte. Njëjtë u dashtë edhe aty me vepruar, ti je tu krijuar situata që janë tu ardhur jo të mira edhe për ty edhe për neve, se krejt e dimë, këtë ti nuk je duke e respektuar, se kuvendi thirret me pikat që i rekomandon KPF-ja. E informata e Kryetarit vjen në kuvend pa KPF. Unë them vazhdojmë me informatën e kryetarit, tjerat pika i hekmi prej rendit të ditës. Kjo është kërkesa jonë për me e vazhduar seancën.

z.Njazi Isaku: Kryesues, në lidhje me vendimin e MAPL-së pajtona edhe se ka qenë pikë me rendësi KAB-i, mirëpo këto pika nuk kanë me kaluar kështu pa kaluar në KPF, se ti e dinë se ai është komiteti ma më rendësi që kanë kuvendet komunale dhe me ardhur pikat në kuvend pa i shqyrtuar në KPF, mendoj se janë shkelje për atë na nuk do të jemi pjesë e kësaj seance.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë nuk i përfilli fontanë dëshirat, e vet është kuvendi i cili i merr vendimet.

znj.Mirlinda Sadiku: Ka të bëjë me kornizën edhe se ka kaluar ju nuk e keni përfillë opozitën, sepse nuk keni marr asnjë rekomandim të cilët janë kanë kërkesa në KPF, absolut nuk i keni marr parasysht.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: E përshëndes Kryetarin që u bashkëngjiti në punimet e seancës këtu, e shih gjithsecili, por e vërteta është një. E din edhe Bekimi e din edhe Njazia, se vendimin që e ka pruar kryesuesi është plotësisht ligjor.

Kryesuesi z.Naim Pira: Edhe një sqarim, propozimin për pikat e rendit të ditës e bën ekzekutivi, kryesuesi e përpilon rendin e ditës dhe kuvendi vendosë a me fol apo mos me fol për atë pikë.

z.Ekrem Abazi: As që e pata ndërmend me diskutuar fare, por më shtyri kjo informata që e dha kryesuesi i kuvendit, se tha ju e keni bojkotuar. Është shumë e vërtetë se ju na keni shtie me bojkotuar, sepse ju nuk keni mund me kalua KAB-in, atë moment që e keni shtie me dhunë dhe kur i keni kontrabandu dy këshilltar, i keni bërë 14, ju deri ato kohë krejt tjerë njerëz keni qenë, tash si e keni bërë numrin jeni bërë tjerë. Atëherë pse ekziston KPF-ja, keni qenë shumë të but deri sa nuk i keni pasur votat, por i ke bërë këshilltarët e mjerë ju me politiken e juaj të keqe, atë moment që i ke bërë 14 ti ma nuk ke ndër fare.

z.Jakup Demiri: Në KPF nuk kemi marr pjesë, ngase në dy mbledhjet e mëhershme kemi pasur telashe. E din kryesuesi, ne kemi dashtë me u marr vesh e jo me bë hajgare me atë komitetet. Tash i keni bë votat këtu edhe po e anashkalon komitetin. Jemi marr vesh para dy mbledhjeve të KPF-së, që mos me ardhur në kuvend ajo pikë. Na keni tradhtuar. Kam propozim që mu hekë ato pika që nuk kanë kaluar në KPF, se s'kena mbajtur mbledhje fare.

z.Samet Idrizi: Po më befason Ekremi. Ti as ma patriot nuk je se unë, as ma familjar, as ma azgan, ti i mjeri i parë je këtu kur nuk të kanë bërë bartës të listës LDK-ja e ke tradhtuar atë, prandaj ke shkuar në AAK. Kam informata se shumë frik ki me dal në VV, kështu që mos me quaj mua i mjerë kur vet je i mjerë. Edhe në fund të

fundit jemi në demokraci, secili ku donë shkon. Këtu ka shumë, Mirlinda ka qenë në AAK ka dalë në VV. Bekimi me dal me fol e heki kapuçin edhe janë do të tjerë këtu, ama me dal me më sulmuar mua njerëzit që e kanë ndërruar partinë para meje. Unë në Zvicerr jam kanë duke punuar, e kam lënë atë edhe jam kthyer, ju kam bashkëngjitur luftës.

z.Ekrem Abazi: Mundem me tu përgjigj, se familja ime historikisht nuk ka qenë familje kombëtare, por kurrë tradhtarë s'ka qenë. Na si familje jemi 100% të pastër, kurrë nuk kemi punuar me atë pushtet.

znj.Mirlinda Sadiku: Po më befason Sameti, se njihemi qysh nga viti 2000 kur kemi punuar në polici, megjithatë të flasësh për familjen time dhe parimet e familjes time, se babë e babagjysh për këtë vend më kanë shkuar. Unë momentin kur është bërë demarkacioni në seancën e fundit, unë kam dhanë dorëheqje. Ju qysh në seancën e dytë e keni shpall një luftë kundër VV-së. Unë Samet nuk e kam ndërruar partinë për interesa, unë jam për parime, nuk jam në shitje. Mua në vitin 2014, me 29 shtator mu kanë dhënë orët, kurse juve ju kanë punësuar gruan, prandaj është e turpshme që bënë paralelizma, andaj larg jemi unë dhe ti.

z.Samet Idrizi: Unë jam në listën e atyre luftëtareve të vërtetë të UÇK-së, që kam pas rastin me luftuar me serb edhe me rus në distancë prej 7-8 metra, ku i kam dy dajë dëshmorë edhe ligji i veteranëve edhe udhëzimi administrativ ma mundëson me punësuar gruan. Ti me burrin tënd je punësuar në kohë të LDK-së, pasi po thua ti jam e parimeve pse nuk nejte në AAK.

z.Ali Bajrami: Këtu nuk po mundem vetëm një gjë me kuptuar, nëse komitetin e ka zgjedhur kuvendi, edhe komiteti me qenë pengesë e funksionimit të kuvendit, për mua është e pakuptimit edhe në drejtimin që ju ka dhënë ministrisë përkatëse është dhënë bre sqarimi, edhe një orë me humbë rreth kësaj teme po më duket humbje kohe. Tjetra, qa desha të themë, në emër të grupit parlamentar të LDK-së jam që kuvendi t'i vazhdoj punimet me pikat që i ka propozuar për seancën e sotshme.

z.Bekim Azizi: E vetmja gjë që me prek sot që jam pjesë e kuvendit që gjashtë vite, që këshilltarët fyhen sot në mes vete. Ali, unë mendoj se banë me shit patriotizëm nga pak, se njerëzit kanë dhanë për këtë vend, mirëpo dikush bënë edhe kryet me ulë para këtyre njerëzve. Unë edhe në fillim thash kryesues, që praktikave të këqija me ju ik, se kemi pas praktika të mira kuvendi, na jena duke i respektuar rregulloret dhe Ligjin mbi Qeverisje Lokale. Po të respektojmë edhe ty kryesues, se ligji ka thanë, ky kuvend e zgjedh kryesuesin dhe kryesuesi i udhëheq punimet; edhe ligji ka thanë, që ky kuvend e zgjedh KPF-në dhe njëjtë ka thanë që KPF-ja i rekomandon pikat dhe i sjell në kuvend, dhe ti nuk po e respekton këtë dhe ti je duke e shkelur ligjin, për ata po them se qe gjashtë vite nuk tu ka bllokuar asnjë pikë që ka qenë e rëndësishme për qytetar. Unë po mendoj, se këtë situatë duhet me kalua, por kjo situatë kalohet vetëm kur ti e respekton rregulloren.

Kryetari z.Sokol Haliti: Unë kam kërkuar që Kuvendi i Komunës së Vitisë duhet me ju kthyer normalitetit të punës. Propozimet për interes të qytetareve duhet me u trajtuar, nuk duhet me u grumbulluar tema edhe rendi i ditës si në Kuvend të Kosovës me ka 60 pika pa u krye, për shkak se unë kam kërkuar që me qenë ekspeditiv edhe me furnizuar kuvendin me pika të rendit të ditës. Unë e di se kuvendi merret edhe me politikë, ajo është pjesë normale, është kulturë politike. KPF-ja është komitet obligativ me ligj i formuar edhe nuk e ka themeluar kuvendi, por kuvendi i ka caktuar anëtarët. Unë ju lus kuvendit pa dallime me ulë kokën a me qua skemë nevojë asnjë, se gjithë jeni të zgjedhur prej sovрани, edhe kryetari i komunës. Na jemi bashkëpunëtor edhe po i shoh disa idhnime që na duhet me i kaluar edhe me ec përpara. Ju lus që të punojmë bashkë dhe i qojmë proceset përpara. Unë jam për bashkëpunim, jam për konsulta. Unë po e shoh se janë sende të vogla me çka jemi duke u marr. Përndryshe vullneti i shumicës duhet me u respektuar.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë po e qesë në votim. Kush është që të miratohet rendi i ditës? Me 14 vota pro kalon rendi i ditës.

Si pikë të parë kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Kuvendit Komunal të Vitisë

A ka dikush rreth pikës së parë? Pasi që nuk ka, e hedhi në votim. Me vota unanime të të pranishmëve në sallë kalon pika e parë.

Si pikë të dytë kemi:

2. Informatë për punën e kryetarit të komunës për periudhën janar-qershor 2019

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Materialin e keni marr me kohë, unë nuk do të ju lodhi për shkak se kaluan dy orë deri sa dolëm në pikën e dytë dhe po e debatojmë një material që është shumë interesant, për shkak se në këtë material të cilin ju e keni para vetës e shini punën e ekzekutivit brenda 6 muajve të cilën është bërë, sfidat të cilat i ka kaluar Zyrat e Kryetarit. Unë nuk do të ju marr ma shumë kohë, se kemi edhe dy pika të cilat janë shumë interesante edhe të cilat lidhen edhe me punën e ekzekutivit, që do ti kemi edhe pasqyrat financiare, por do ta kemi edhe një raport të auditorit të jashtëm, i cili e ka bërë një vlerësim për Komunën e Vitisë. Kjo ishte në pika të shkurtra.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

z.Ali Bajrami: E falënderojmë nënkryetarin për elaborimin për këtë periudhë të informatës së punës së Kryetarit janar – qershor 2019. Duke u nisur prej zyrave të kryetarit, auditimi i brendshëm njësia e personelit zyra komunale për kthim prokurimi informimi avokatit publik komunal zyra projektuese për periudhën kohore 6 mujore të gjitha këto zyre që janë të lidhura direkt me kryetarin e kanë kryer punën në mënyrën ma të mirë të mundshme dhe në përputhje me ligjin është bërë një punë e madhe është bërë një punë e përgjegjshme është bërë një punë që është duke u vlerësuar edhe nga qytetarët. Ajo çka e bënë edhe ma të suksesshëm punën e kryetarit për këtë periudhë 6 mujore, janë edhe drejtoritë që janë duke punuar në mënyrë të palodhshme, me një angazhim shumë të madh, që të jenë sa ma të përgjegjshëm dhe të dalin sa ma të mirë në krahasim edhe me atë çka e bëjnë për qytetarët e Komunës së Vitisë. Krejt kjo periudhë është përcjell me një rregullaritet, me një angazhim. I përgëzoj për punën e bërë, ju dëshiroj suksese dhe shëndet edhe në të ardhmen.

znj.Gjylsime Qamili: Vërtet është për ta përshëndetur për punën qa është bërë nga kryetari Haliti me bashkëpunëtorët e tij, në përpilimin e këtij raporti 6 mujor për vitin 2019. Ky raport, që ne veç e kemi para vetës, tregon një qasje të drejtë dhe serioze të kryetarit ndaj qytetarëve të komunës sonë. Unë do të ndalem për një shpjegim në vizitat që ofron stafi i QKMF-së në Viti, në veçanti nxënësve të këtyre shkollave, pasi që vij edhe nga kjo sferë dhe kam informata, pasi e pash se te raporti 6-mujor nuk ishte paraqitur. Vazhdimisht kemi pasur vizita, vërtetoj këtë, se stafi i QKMF-së në viti në maj të po këtij viti bëri vlerësimin e gjendjes shëndetësore të nxënësve të shkollave fillore të komunës sonë. Kështu që realizoi projektin e kontrollës sistematike të nxënësve të shkollave të kësaj komune. Qëllimi i këtij projekti ishte zhvillimi, evidentimi, parandalimi dhe mjekimi i hershëm dhe me kohë i të gjitha sëmundjeve dhe anomalive të nxënësve të shkollave, ku në fokus ishin grupet e caktuara, klasat e pesta, ku gjatë vizitës janë vlerësuar 30 parametra mjekësor dhe kontrole dentare të dhëmbëve nga stomatologu. Janë përfshi 17 shkolla dhe janë vizituar 654 nxënës. Shpresoj se kjo praktikë të vazhdoj edhe gjate viteve të tjera, pasi që është në të mirë të qytetareve. Kemi pas edhe vizitat nëpër shtëpi, që ka filluar nga marsi i vitit 2018, ku vetëm në 6-mujorin e parë të kësaj janë realizuar 228 vizita. Vizitat për të moshuarit dhe gjendjes terminale për gjashtëmujorin e parë 639 vizita, ku me plotë të drejtë themi se është lehtësuar gjendja e qytetareve në komunën tonë. Kujdes po ashtu në këtë gjashtëmujor i është kushtuar të sëmurave me sëmundje mendore, përcjellje, vizita të rregullta si dhe aplikimi i terapisë së nevojshme, gjithherë në bashkëpunim me Qendrën e Shëndetit Mendor në Gjilan. Në fund, stafit të QKMF-së ju uroj punë të mbarë e nxënësve dhe qytetarëve shëndet.

Kryesuesi z.Naim Pira: Dikush tjetër a donë ta merr fjalën? Nëse nuk ka, e falënderoj kryetarin dhe kabinetin e tij për gatishmërinë që ka pasur ta sjell këtë informatë para kuvendit.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën Janar - Qershor 2019

Ja kisha kaluar fjalën drejtorit.

z.Ibrahim Rama: Pasqyrat financiare janë formuar konform nenit të ligjeve që janë në fuqi. Materialin e keni marr me kohë dhe keni mund me analizuar. Unë vetëm në pika të shkurtra, sepse do ta lë debatin me juve, por ajo çka është primare, se pasqyrat financiare tregojnë se ekzekutimi i buxhetit për vitin 2019 Janar – Qershor është në përqindje 78.77 % sipas kategorive shpenzuese. Për paga 99.93%, për shërbime dhe mallra 68%, shpenzime komunale 94%. Këto janë ato shpenzimet. Nuk do të ju marr kohë ma shumë, kush është për ndonjë pyetje apo ndonjë sqarim jam në dispozicion e juaj që ti debatojmë së bashku.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rrethë kësaj pike, a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

z.Samet Idrizi: Unë po lidhem te rritja e shpenzimeve. Pash disa vende se ka rritje, shpenzimet e udhëtimit brenda vendit vitin e kaluar kanë qenë 7934 euro, tash janë 13612 euro, është një rritje bukur e madhe. Pse ka ndodhur kjo. Po ashtu udhëtime jashtë vendit ka rritje prej 2258 në 6029 euro, shpenzimet e rrymës nga 90 mijë janë rritur në 100 mijë. Është mirë me qenë ma të kujdesshëm, është çdo rrugë me qenë me ndriçim po karshi standardit që e kemi edhe mundësisë financiare është mirë me qenë pak të rezervuar. Shpenzimet e ujit nga 8135 në 16190 euro, këtu me siguri vonesa e procedimit është vonesa e faktuarve dhe pagesave. Është mirë me qenë ma azhur, e din edhe drejtori, mirëmbajtja dhe rregullimi i automjeteve po ashtu është një rritje nga 13 mijë euro në 18182 euro. Unë e di se këta janë shumica tender publik të hapur dhe nuk mund me diktua në çmim, sepse është tender i hapur, veç me na treguar drejtori pse kemi rritje, a është për shkak të shtimit të kapacitetit apo ka ratisë tenderi të jetë kështu. Investimet kapitale, përafërsisht janë të njëjta me të vitit të kaluar. Kam një pyetje, te pagesa e vendimeve gjyqësore është shumë e madhe 2017, 2018, 2019. Dëshiroj të di, të marr një informatë, pse këto pagesa të vendimeve gjyqësore kaq të mëdhaja. A janë duke u përcjell në periudha a për qa. Kjo ka qenë ma brengoseshë për mua në krejt këto pasqyra financiare. Planifikimi është përafërsisht si në vitin e kaluar, donacionet janë përafërsisht të njëjta, pak ma të mëdhaja. Sa i përket investimeve kapitale, ku paraqitet në mënyrë grafike të hyrat vetanake janë 00. Këto me siguri do të shfaqen ma vonë, grandit qeveritar 94.11% krahasuar me vitin e kaluar si do që të jetë më erdhi mirë që viti 2019 ka një rritje shumë të mirë të invadimeve në krahasim me vitet tjera kisha pas dëshirë me ditë si ka ndodhur.

z.Ali Bajrami: Nëse ndalim dhe e shikojmë ekzekutimin e buxhetit, 78,77%, në këtë përqindje pjesa ma e madhe është për paga dhe mëditje dhe shërbime dhe mallra. Ajo çka është pak në krahasim me përqindjen të kapitalet 37,14%, por kur merret parasysh dinamika e punëve edhe duke u bazuar në praktikat e viteve të kaluara, kur e kemi pas shpenzimin mbi 99%, nuk dyshojmë se edhe këtë vit do ta kemi një shpenzim të tillë. Te drejtoritë, që është niveli ma i vogël 40%, lidhet me këtë se investimet kapitale janë ato që ndikojnë direkt në këtë përqindje, që është me e ulët, që vlenë të ceket dhe të përgëzohen për një punë të mirë që është bë të të hyrat vetanake, që kanë një përqindje shume të mirë në krahasim me vitet e kaluara. Është mirë që kemi këtë inkasim, janë mjete që i kthehen direkt qytetarëve dhe hinë në shërbim të qytetarit. Ajo çka është pak që duhet t'i kushtojmë rendësi, është të vendimet gjyqësore. Ndodhin këto, janë praktika që përcjelljen, mirëpo duhet të bëjmë përpjekje që këto t'i eliminojmë.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Pyetja e Sametit edhe përgjigjen i ka brenda pyetjes, për arsye se është professionalist i lemis përkatëse. Shpenzimet sipas disa pozicioneve, pse janë me shumë e dikune me pak, nuk muj me dhënë sqarime, sepse ne brenda secilit kod janë ato arsyetimet e shpenzimeve që kane ndodh, po këtu janë disa segmente që munden me ndiku më shumë ose me pak. Një është, buxheti, planifikimi për të gjitha drejtoritë nuk ka mujt me qenë planifikimi i njëjtë për asnjë buxhet ne të gjitha parametrat e strukturave të buxhetit. E ligjërish buxheti duhet mu ekzekutu ashtu qysh është, i planifikuar. Pasqyrat financiare paraqesin saktë buxhetin e paguar, jo të shpenzuar po të paguar. Te shpenzimet e gjyqësorit që janë pagu nga shpenzimet që i ka inkasu përmbaruesi privat, kemi telashe në këtë vij, meqenëse sipas ligjeve që janë në fuqi, zakonisht pjesa e madhe e këtyre pagesave të gjyqësorit janë të pagave të ish punëtorëve që kanë qenë në Komunën e Vitisë të punësuar dhe deri në këtë vit ligji nuk naj ka

parapa shumë e buxhetit me i pagu tri pagat jubilarë dhe tri pagat e pensionimit. Kështu që, ata me ligj po e fitojnë të drejtën me i inkasë të hyrat e thesarit, nuk po na vet, po i merr aty ku po i gjenë të lira, kurse për vitin 2019 e tutje i kemi të planifikuara në buxhet dhe nuk kemi me pas problem me gjykata e as me përmbarues privat.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ju falënderoj për sjelljen e pasqyrave dhe si pikë të katër kemi:

4. Informatë lidhur me Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë për vitin përfundimtar me 31.12.2018

Drejtori z.Ibahim Rama: Raporti I auditorit gjeneral është obligim ligjor që të auditon çdo komune për çdo vit. Në këtë drejtim ne jemi vlerësuar me notën opinion I pa modifikuar, pa theksim të çështjes që jemi të kënaqur me këtë vlerësim, meqenëse është viti i tretë që po notohemi e vetmja komune në Kosovë, ren tri vjet e kemi pamodifikuar, pa theksim të çështjes. Në këtë vit vetëm tri komuna për momentin e kanë këtë rezultat. Është Shtimja, Ranilluku dhe Vitia. Në këtë drejtim kemi komplimente nga Zyra e Auditimit. Materialin e kemi pranuar me kohë, për pyetjet shpeshë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë.

z.Samet Idrizi: Në faqe nr. 5, mangësi e vendimit për shfrytëzimin e pronave. Këtu bëhet fjalë për pronat publike, të dhëna me qira, ku është një lëshim këtu bukur serioz. Është mirë herëve tjera me pas kujdes këtu. Opinioni është I pamodifikuar, është shumë mirë, kjo besoj është dhe meritë e kuvendit, sepse kuvendi gjithmonë ka sugjeru që të punohet më mire. Edhe vërejtja tjetër, vonesa e nënshkrimit të deklaratës nën betim. Këtu duhet të jete zyrtari I prokurimit me sy qel, që deklaratat nën betim të komisionit të vlerësimit të nënshkruhet me kohë, se ka pas raste ku edhe viteve tjera auditori ka has ne deklarata nën betim të panënshkruara fare.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Për sqarim, tek rekomandimi për mangësitë në vendim për shfrytëzimin e pronave. Këtu nuk paraqitet saktë se çka ka ndodhë me këtë rekomandim. Drejtorja e Shërbimeve Publike janë në ngjarje, e kemi konsultu këtë rekomandim. Të gjitha kontratat që I kanë gjetë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike kanë qenë në rregull, po kanë kërkuar që mu specifiku secila kontratë, si p.sh.: me metra katror.

Kryesuesi z.Naim Pira: Si pikë tjetër të rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për inicimin e themelimit të Teatrit të Qytetit

Drejtori z.Milot Lala: Përshëndetëj të nderur të pranishëm! Kemi propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për inicimin e themelimit të Teatrit të Qytetit. Në mbështetje të nenit 58, pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 4 pika 3 të Ligjit për Teatrot nr.4 L-106, rregullores nr. 04/2015 (MKRS) për kushtet dhe kriteret e themelimit të teatrove kombëtare dhe të teatrove të qyteteve, kryetari i Komunës bënë këtë propozim vendim për inicimin e themelimit të Teatrit të Qytetit. Materialin e kemi marr me kohë, për pyje shpeshë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës, për propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për inicimin e themelimit të Teatrit të Qytet. Pasi që nuk ka për diskutim, unë e qes në votim që të themelohet teatri I qytetit. Konstatoj që me 14 vota pro themelohet teatri I qytetit.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2020

Kryesuesi z.Naim Pira: Ne e kemi themlu grupin punues për hartimin e planit të punës së kuvendit për vitin 2020 dhe kemi pas një takim të sponsorizuar nga OSBE-ja, që unë si kryesues I kuvendit dhe sekretaria I kemi thirr të gjithë akteret, që të kontribuojnë në përgatitjen e planit të punës së kuvendit. Unë hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim. Me 14 vota pro shkon në diskutim publik.

Si pikë të shtatë dhe të tetë i kemi dy rregullore që janë përafërsisht të njëjta

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik për propozim rregullore për Tatimit në prone për vitin 2020 dhe 8, propozim për shqyrtimin dhe miratimin

e propozim vendim për shpalljen ne diskutim publik, propozim rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2020

Janë dy rregullore që do t'i nënshtrohen diskutimit publik dhe duhet prapë ti sjellim ne kuvend për miratim. Unë hapi diskutim për këto dy rregullore.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Është fjala për propozim vendimi për shpalljen ne diskutim publik për propozim për ndryshimin e rregullore për tatimin në pronë. Këtu kemi dy gabime teknike të datat, ku thuhet diskutimi publik do të jepet deri me datën 30.08.2019. Kjo do të ndryshohet, duhet te jetë 03.09.2019 dhe debatet publike do të mbahet jo me datën 16.08.2019, po me datën 05.09.2019. Këto janë dy ndryshimet.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë po e qes në votim. Me 14 vota pro votohen edhe këto dy pika. Unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë në këtë seancë, edhe njëherë po e përsëris, ftoj pjesën tjetër të opozitës, që t'i bashkëngjitet punimeve të seancës dhe të KPF-se, sepse kane votën e qytetarëve dhe natyrisht këtu diskutojmë për interesat e qytetarëve.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:45 min.

Procesmbajtësi:
Iliri Zuka

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Naim Pira
